



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Analiza e të dhënave për vendimmarrje në biznes EKB0040

| | |
|-------------------------|--------------------------------|
| Bartësi i lëndës: | Endrit Pllashniku |
| Email: | endrit.pllashniku@riinvest.net |
| Telefoni: | |
| Mësimdhënësit e Lëndës: | Rinor Sadiku |

Hyrje

Analiza e të dhënave për vendimmarrje në biznes shpalos mundësitë e përdorimit të të dhënave statistikore për krijimin e modeleve analitike dhe për të ndihmuar vendimmarrjen menaxheriale. Kjo lëndë zhvillon ekspertizë në një sërë standardesh të teknikave statistikore dhe grafike, të cilat do të jenë të dobishme në analizimin e të dhënave që lidhen me biznesin. Këto teknika aplikohen gjerësisht në një numër fushash të menaxhimit të biznesit, duke përfshirë menaxhimin e operacioneve, marketingun, financat, shitjet etj.

Qëllimet

Qëllimi i lëndës është të shqyrtojë dhe t'i përgjigjet pesë pyetjeve kryesore të procesit të analizës së të dhënave: 1. Çfarë keni nevojë të parashikoni ose të vlerësoni? 2. Si do të mblidhni të dhënat? 3. Si të vizualizoni të dhënat dhe të eksploroni modelet apo anomalitë? 4. Si të ndërtoni, aplikoni dhe të vërtetoni besueshmërinë një model parashikues? 5. Si të përdorni modelin për të treguar një histori?

Rezultatet e pritura të lëndës

- Pas përfundimit të kësaj lende, ju duhet të jeni në gjendje të:
 1. Vlerësoni se mbledhja dhe analiza statistikore e të dhënave përmirëson vendimet e biznesit dhe zvogëlon rrezikun e zbatimit të zgjidhjeve të cilat shkaktojnë përdorim të panevojshëm të burimeve dhe kapaciteteve biznesore.
 2. Zgjidhni dhe vendosni në përdorim metodën e saktë statistikore për një kërkesë të caktuar të analizës së të dhënave. Në veçanti, zhvilloni ekspertizë në përshkrimin e të dhënave, menaxhimin e proceseve, testimin e hipotezave dhe ndërtimin e modelit.
 3. Arrini një nivel praktik të kompetencës në ndërtimin e modeleve statistikore që i përshtaten nevojave të biznesit.
 4. Njihni, zhvilloni dhe dalloni modelet e analizës së të dhënave ndër-seksionale dhe atyre të serive kohore
 5. Aftësoheni në përdorimin SPSS-in, Excel-in, the TABLEAU Public si aplikacione statistikore për analizën dhe vizualizimin e të dhënave dhe interpretimin e rezultateve.
 6. Rrisni aftësitë tuaja si menaxher për të "menduar statistiki" duke përdorur të dhënat dhe për të përdorur këtë aftësi për të mbështetur intuitën tuaj biznesore.

Programi

| Java | Tema | Aktivitetet |
|------|---|---|
| 1 | Hyrje në konceptin e të dhënave, grumbullimi i të dhënave dhe rëndësia e përdorimit të të dhënave në vendimmarrje biznesore | |
| 2 | Shqyrtimi i koncepteve themelore të probabilitetit | |
| 3 | Llojet e Variablave, Statistikat përshkruese, Shpërndarja e të dhënave | Përdorimi i Tableau Public |
| 4 | Vizualizimi i të dhënave | Përdorimi i Tableau Public |
| 5 | Vizualizimi i të dhënave | Përdorimi i Tableau Public |
| 6 | Mostra dhe mostrimi reprezentativ, Intervallet e konfidencës, Testet statistikore – T-test, Chi- square | Shpërndarja e udhëzimeve për detyrën finale |
| 7 | Marrja e vendimeve në kushte të pasigurisë, Testimi i hipotezave, Vlera P | |
| 8 | Statistikë Inferenciale - ANOVA | |
| 9 | Regresioni linear i thjeshtë | |
| 10 | Regresioni linear i thjeshtë | |
| 11 | Regresioni linear me shumë variabla | |
| 12 | Regresioni linear me shumë variabla | |
| 13 | Regresioni linear me shumë variabla | |
| 14 | Regresion logjistik | |
| 15 | Mentorim individual | Dorëzimi i Detyrës |

Informata shtesë 1:

Vlerësimi:

| Nr. | Lloji | Përqindja | Oblig. | Përshkrimi |
|-----|---------------|-----------|--------|--|
| 1 | Detyra | 40 | | Analiza eksploruese e të dhënave; Krijimi i dashboards në Tableau Public. Pesha maksimale që mund të arrihet sipas afateve në të cilat dorëzohet detyra: Afati 1- 40 %, Afati 2- 30 %, Afati 3- 20 % |
| 2 | Provimi Final | 50 | | Ndërtimi i modelit parashikues me të dhëna reale. Provimi final mbahet në laborator të kompjuterëve duke përdorur SPSS dhe Excel; |
| 3 | Pjesëmarrja | 10 | | Pjesëmarrja dhe interaktiviteti në klasë |

Kushtet e përsëritjes:

Sipas Nenit 13 të rregullores së studimeve Baçellor të Kolegjit Riinvest, studenti obligohet të kalojë lëndën me sukses pas tri (3) nënshtrimeve në provim. Nëse studenti nuk i nënshtrohet provimit në lëndën e caktuar në afatin e dhënë, atëherë i llogaritet që ka shpenzuar afatin e rregullt ose kompensues të ofruar. Nëse pas tri afateve të provimit studenti nuk kalon lëndën, atëherë ai obligohet të dëgjojë sërish lëndën në vitin vijues akademik.

Burimet:

- Materiali shtesë vendoset në e-learning

Ndërtimi i ECTS-ve

| Aktiviteti | Nr i oreve per Aktivitetin | |
|--------------------------------|----------------------------|--|
| Ligjerata: | 30 | |
| Ushtrime: | 15 | |
| L+U: | 45 | |
| Seminar/praktike.: | 45 | |
| Studim i vazhdushem: | 45 | |
| Pregaditja e Provimit: | 20 | |
| Pjesemarrja ne teste: | 3 | |
| Pjesemarrja ne provimin final: | 1 | |
| Me profesorin dhe asistentin: | 6 | |
| Total Ore: | 165 | |
| ECTS: | 6 | |